

20210911402

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 1

Në Ligjin e Komunikimeve Elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 98/19 dhe 153/19), në nenin 8 pika 32) ndryshohet si më poshtë:

"32) kufizon, ndalon dhe/ose imponon kërkesa specifike dhe kushte, në lidhje me furnizimin, përdorimin dhe punën e pajisjes për rrjetet komunikuese elektronike, duke përcjellë qasje të bazuar në vlerësim të rrezikut, duke e marrë parasysh:

- sigurinë e komponentëve kritikë dhe të pjesëve të ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike tek operatorët,
- sigurinë e vetë pajisjes për rrjetet komunikuese elektronike,
- rrezikun nga përfshirja e vendit të tretë në zinxhirin e furnizimit të pajisjes për rrjete komunikuese elektronike,
- rrezikun nga varësia e madhe e një furnizuesi dhe një prodhuesi në nivel të operatorit ose në nivel nacional,
- rreziqet për sigurinë nacionale."

Neni 2

Në nenin 34 paragrafi (1), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "si dhe mbikëqyrje profesionale me qëllim të analizës së hollësisme teknike të komponentëve kritikë dhe të pjesëve të ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike."

Neni 3

Në nenin 55 paragrafi (1), në pikën e), lidhëza "dhe" zëvendësohet me "presje".

Në pikën 3), "pika" zëvendësohet me "presje".

Pas pikës f), shtohen dy pika të reja g) dhe gj), si më poshtë:

"g) plane dhe furnizim të pajisjes për rrjetet komunikuese elektronike dhe
gj) plane për përfshirjen e palëve të treta në procesin e furnizimit."

Neni 4

Pas nenit 166 shtohen pesë nene të reja 166-a, 166-b, 166-c, 166-ç dhe 166-d, si më poshtë:

"Neni 166-a

Vlerësimi i profilit të rrezikut të furnizuesit dhe të prodhuesit të pajisjes për rrjete komunikuese elektronike të operatorët

(1) Agjencia, në bashkëpunim me Qendrën Nacionale përPërgjigje të Incidenteve Kompjuterike, në mënyrë periodike përpilon vlerësim të hollësishëm të profilit të rrezikut në nivel nacional të të gjithë furnizuesve relevantë dhe të prodhuesve të pajisjes së rrjetit të operatorët.

(2) Agjencia imponon detyrime për kufizimin ose përjashtimin e mundësisë për furnizim të pajisje për komponentë kritikë dhe për pjesët e ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike me qëllim zbutjen e rreziqeve për sigurinë e rrjetit, nga furnizues dhe prodhues të cilët konsiderohen me rrezik të madh, në pajtim me vlerësimin e profilit të rrezikut sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Agjencia, që të bashkëpunjë me Qendrën Nacionale për Përgjigje të Incidenteve Kompjuterike i cakton edhe komponentët kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike.

(4) Gjatë vlerësimit të profilit të rrezikut për furnizues dhe prodhues të pajisjes së rrjetit, Agjencia do t'i marrë parasysh veçanërisht këto faktorë:

- nëse furnizuesit dhe prodhuesit janë në mbikëqyrje të qeverisë së shtetit tjetër pa kontroll të pavarur gjyqësor,

- nëse furnizuesit dhe prodhuesit kanë informata publikisht të qasshme për themeluesit e tyre, bashkëpunëtor afaristë, si dhe për organet e menaxhimit dhe udhëheqjes,

- nëse furnizuesit dhe prodhuesit përkrahin inovacione dhe i respektojnë të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme, si dhe të drejtat nga pronësia industriale,

- nëse furnizuesit dhe prodhuesit financohen në mënyrë transparente, në pajtim me praktikat më të mira për furnizim, investime dhe lidhje të marrëveshjeve.

(5) Drejtori i Agjencisë miraton metodologji për vlerësimin e profilit të rrezikut të furnizuesve dhe prodhuesve të pajisjes së rrjetit, me ç'rast merren parasysh kërkesat nga paragrafi (4) të këtij neni.

(6) Drejtori i Agjencisë miraton listë të komponentëve kritikë dhe pjesëve të ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

Neni 166-b

Detyrime të operatorëve

(1) Operatorët vendosin procedura dhe miratojnë masa kontrolli me qëllim menaxhimit efikas me rreziqe potenciale të cilët kanë të bëjnë me furnizuesit dhe prodhuesit, në pajtim me profilin e tyre të rrezikut, në pajtim me nenin 166-a, paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Operatorët zbatojnë masa teknike nëpërmjet:

- zbatimit të masave për kontroll të qasjes në rrjetin,

- zbatimit të parimit të ndarjes së privilegjeve më të vogla me qëllim qasja te elemente të ndryshme të rrjetit të jetë i minimizuar,

- zbatimit të parimit të ndarjes së përgjegjësisë, me qëllim zvogëlimin e gabimeve dhe mashtrimeve,

- kufizimit dhe monitorimit të qasjes nga largësia për furnizues dhe prodhues, veçanërisht në ata të cilët janë të vlerësuar me rrezik të lartë, në pajtim me profilin e tyre të rrezikut,

- zbatimit të mekanizmave adekuate për autentikim, autorizim, evidentimi të shkresave për qasje dhe kontrole të rregullta, me qëllim të ketë pasqyrë të qasjes të dhënat, ndryshimet në pikëpamjet ose ndryshimet në elemente e rrjetit,

- zbatimi i praktikave më të mira të virtualizimit i funksionaliteteve të rrjetit, duke e marrë parasysh se te komponentët kritikë dhe pjesët të ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike mund të jetë e nevojshme ndarje fizike e resurseve.

(3) Operatorët, gjatë furnizimit të pajisjes, duhet të kenë kërkesa të veçanta të sigurisë, si:

- të sigurojnë riparime të sigurisë gjatë kohës së të gjithë afatit të qëndrueshmërisë së pajisjes,

- të sigurojnë siguri në procesin e zhvillimit të pajisjes dhe prodhimeve shoqëruese.

(4) Operatorët miratojnë plane për vazhdimësi të punës dhe rimëkëmbje nga katastrofat, që e tangojnë funksionalitetin e rrjeteve.

(5) Operatorët shfrytëzojnë shërbime nga furnizues dhe prodhues të cilët mund të sigurojnë përkrahje për planet sipas paragrafit (4) të këtij neni.

Neni 166-c

Menaxhimi i sigurt, puna dhe monitorimi i rrjeteve komunikuese elektronike te operatorët

(1) Operatorët, në korniza të infrastrukturës së tyre, themelojnë qendra për operacione të rrjetit dhe/ose qendra për operacione të sigurta, me qëllim zbatimn dhe përcjelljen e masave për menaxhim të sigurt dhe punë të rrjetit.

(2) Qendrat e paragrafit (1) të këtij neni themelohen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Qendrat e paragrafit (1) të këtij neni duhet të sigurojnë:

- sisteme për monitorim të së paku komponentëve kritikë dhe t pjesëve të ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike,

- detektimin e të metave në rrjet,

- identifikimin dhe parandalimin e kërcënimeve për funksionimin e rrjetit.

(4) Operatori e mbron komunikacionin që shfrytëzohet për menaxhimin e rrjeteve të komunikimit me qëllim shmangien e qasjeve të paautorizuara dhe të ndryshimeve të paautorizuara.

(5) Operatori siguron:

- mbrojtje të përfuruar fizike të komponentëve kritikë dhe pjesëve të ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike,

- qasje fizike te komponentët kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike për personel të kufizuar i cili është i trajnuar dhe kualifikuar për atë dedikim,

- qasje rreptësisht e kufizuar dhe fizikisht të mentoruar te komponentët kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve komunikuese elektronike për furnizues, prodhues ose palë të treta.

(6) Operatori vendos mekanizëm për sigurimin e integritetit të softueri gjatë instalimit të mbindërtimeve dhe riparimeve të sigurisë në softuer.

Neni 166-ç

Kontroll kur kompetencat e mirëmbajtjes së pajisjes së rrjetit i janë bartur personit tjetër

Kur operatori i bart kompetencat fizike dhe virtuale të mirëmbajtjes së pajisjes së rrjetit, te persona të tjerë, është e nevojshme të vendos kontrole të përfurcuara të sigurisë gjatë sigurimit të qasjes te elementet e rrjetit, veçanërisht nëse mirëmbajtja e pajisjes është siguruar nga furnizues ose prodhues me rrezik të madh në pajtim me profilin e tyre të rrezikut sipas nenit 166-a paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 166-d

Sigurim i furnizuesve të ndryshëm dhe i prodhuesve të pajisjes së rrjetit

Operatorët, gjatë furnizimit të pajisjes së rrjetit:

a) kanë qasje për zgjedhjen e furnizuesve të ndryshëm dhe prodhuesve të pajisjes, duke i pasur parasysh kufizimet teknike dhe kërkesat për interoperabilitet të pjesëve të ndryshme të rrjetit, me qëllim të shmangen ose ta kufizojnë pavarësinë nga një furnizues dhe prodhues;

b) duhet të shfrytëzojnë certifikim të BE-së për komponentë të rrjetit, pajisje për shfrytëzues dhe/ose procese të furnizues dhe prodhues, nëse në treg ofrohen komponentë të cilat kanë certifikim të tillë;

c) duhet të shfrytëzojnë certifikim të BE-së për IKT prodhime të tjera jospecifike dhe shërbime, nëse në treg ofrohen komponentë të cilët kanë specifikim të tillë;

ç) e kanë parasysh rrezikun e përgjithshëm të ndikimit në furnizuesin dhe prodhuesin nga vendi i tretë, veçanërisht në lidhje me:

- sistemin e menaxhimit,
- ekzistimin e marrëveshjeve për bashkëpunimin në sferën e sigurisë ose marrëveshjeve të ngjashme, siç janë vendimet për harmonizim në sferën e mbrojtjes së të dhënave,
- nëse vendi është palë e marrëveshjeve shumëpalëshe, ndërnacionale ose dypalëshe për sajber siguri, luftë kundër krimit kompjuterik ose mbrojtjes së të dhënave."

Neni 5

Në nenin 180 paragrafi (1), në pikën 26), lidhëza "dhe" zëvendësohet me "presje" dhe shtohet pikë e re 27) si më poshtë:

"27) Operatorët gjatë furnizimit të pajisjes së rrjetit nuk i kanë pasur parasysh dispozitat e nenit 166-d dhe"

Pika 27) bëhet pikë 28).

Neni 6

Dispozitat e përcaktuara sipas nenit 166-d paragrafi (1) nënparagrafi b) dhe c) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen prej 28 qershorit 2021.

Neni 7

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".